



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr _____ Pr

Berat, më 06 /11/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndertim i rruges prane Vala Park”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7__pune ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 15.003.838 (pesëmbëdhjetë milion e tremijë e teteqind e tridhjetë e tete leke pa tvsh) vënë në dispozicion

Kontraktori është i detyruar të përfundojë të gjitha punimet (volumet e parashikuara në preventiv) sipas afateve të zbatimit të punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve përkatëse.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Patos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e e parashikuar e kontratës që po prokurohet (**jo me e vogël se vlera e fondit limit**).

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, bazuar në neni 42 të Aktit Normativ 9/2019, nenin 77, pika 3, e LPP dhe nenit 43, pika 5, e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Autoriteti në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në neni 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020,2021,2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim : Në respektim të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëqoftëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Aftesite Teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme të ngjashme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
1. Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 2. Situacionin përfundimtar të objektit;
 3. Fatura tatimore përfundimtare.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Shënim: (Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).

- 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ne baze të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:
- NP-1 A : Punime gjermimi në tokë.
 - NP-4 A : Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale.
 - NP-5 A : Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
 - NS-1 A : Punime për prishjen e ndërtimeve
 - NS-6A : Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
 - NS-18 A :Punime topogjeodezike

Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet te disponoje kategorite e licences sipas marreveshjes se bashkepunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gjermave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

➤ **NP-1: Punime gjermimi në tokë.**

“Kategoria A”

Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

➤ **NP-4: Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale. “Kategoria A”**

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

➤ **NP. 5: Punime nëntokësore, ura e vepra arti. “Kategoria A”**

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

➤ **NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve. “Kategoria A”**

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **NS-6: Sinjalistika rrugore jo ndriçuese “Kategoria A”**

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

➤ **N.S - 18 Punime topogjeodezike “Kategoria A”**

Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse								
NP-1	Punime gjurmimi në tokë	Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	Kategoria A	0-20 milion lekë								
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale	3.21 Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri m2 683.0 904.0 3 3.212c Shtrese stabilizant t=15cm m2 683.0 617.0 4 3.222/2 Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri m2 1,033.0 1,664.0 5 3.226/1 Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	Kategoria A	0-20 milion lekë								
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	<table border="1"><tr><td>An-23</td><td>Puseta shiu40*60 ,h=100cm me kapak gize</td></tr><tr><td>2.26</td><td>Shtrese rere(</td></tr><tr><td>3-an,1t</td><td>F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=315mm</td></tr><tr><td>3-an,1t</td><td>F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=600mm</td></tr></table>	An-23	Puseta shiu40*60 ,h=100cm me kapak gize	2.26	Shtrese rere(3-an,1t	F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=315mm	3-an,1t	F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=600mm	Kategoria A	0-20 milion lekë
An-23	Puseta shiu40*60 ,h=100cm me kapak gize											
2.26	Shtrese rere(
3-an,1t	F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=315mm											
3-an,1t	F.v tuba te brinjezuar HDPE SN 8 d=600mm											



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve				Kategoria A	0-20 milion lekë
		An-49	Prishje struktura prej betoni(muri rrethues ekzistues-themeli i betonit)			
		An	Skarifikim shtrese asfalti rruge ekzistuese me makineri			
NS-6	Sinjalistika rrugore ndriçuese	1	An123	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm. Bikoponente (paste0 An 151 Vizime me boje bikompomente	Kategoria A	0-20 milion lekë
NS-18	Punime topogjeodezike				Kategoria A	0-20 milion lekë

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. **Inxhinier Ndertimi 1 (nje)**

- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete **1(nje) Inxhinier Gjeodet** me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi.
- Operatori ekonomik ofertues duhet te kete **1(nje) Inxhinier Elektrik** me kontrate pune ose kontrate bashkepunimi

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme,

Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

- **Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “*drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi*” .

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)**
- b. **Karpentiere 3 (tre)**
- c. **Shtrues pllakash 3 (tre) .**
- d. **Punetore te thjeshte 5 (pese)**
- e. **Shofere 2 (dy)**
- f. **Manovratore 3 (tre)**
- g. **Elektracist 1 (nje)**

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ose ekuivalent.
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:
-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredheni te punes	Nr.certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues
----	--------------	------------	--	------------------------------	-----------------------------------

- **Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinieri i Ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zberthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të asfaltit, betonit, hekurit etj.

Inxhinier Gjeodet eshte pergjegjes per zbatimin e sakte te punimeve te objekti qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve te ndertimit te objekti pjese e fushes se tij, zberthimin e projektit topografik kuotat dhe permasat e mureve mbajtese dhe kuotat e shtresave te shtrimit te shesheve, kuotat e tubacioneve te shkarkimit te ujrave te bardha (KUB). Ai eshte pergjegjes per kutat e te gjithë objektit.

Inxhinier elektrik eshte pergjegjes per zbatimin e punimeve te ndertimit te objekti per zerat e punimeve te fushes se tij, zberthimin e sakte te projektit, punimet e sistemit elektrike dhe per cilesine e materialeve elektrike si psh shtylla, ndricues, kabull etj.

Tekniku i ndertimi eshte pergjegjes per organizimin e zbatimin e punimeve te ndertimit te objekti per te gjithë zerat e punimeve te objektit, zberthimin e sakte te projektit, punimet e ndertimit dhe per cilesine e materialeve qe vendosen ne objekt.

Karpentiere eshte pergjegjes per pergatitjen e armatures se derases dhe betonimin e strukturave te ndryshme b/a ne objektik qe prokurohet.

Shtrues pllakash eshte pergjegjes per shtimin me pllaka te betonit ne ambientet e jashtme ne objektin qe prokurohet.

Shofere jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

Manovratore jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Punetor i thjesht është përgjegjës për punimet të ndryshme sipas preventivit si psh. Vendosijen e tubove të brinjezuar, shtrese rere etj.

Elektricitist 1 (nje) është përgjegjës për punimet të ndryshme sipas preventivit si psh: lidhjen e ndricuesve, lidhje e fijeve, tokezimet etj.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 21 (njëzetë e një) punonjës per muajin e fundit.** Periudha për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për muajin e fundit
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit

***Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për njëpunësim të paktën 30 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kater elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport) zeri fuqi puntore ze rreth 20% të kostos.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- | | |
|------------------------------|----------------|
| • Teknike ndertimi | 1(nje) |
| • karpentiere | 3 (tre) |
| • shtrues pllakash | 3 (tre) |
| • Puntore te thjeshte | 5(pese) |
| • Shofere | 2 (dy) |
| • Maovratore | 3 (tre) |
| • Drejtues Teknik | 1(nje) |
| • Inxhiniera | 2 (dy) |
| • Elektracist | 1 (nje) |

TOTALI = 21 Persona ne Staf (njezete e nje).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- | | |
|---|-------------------------|
| • Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 18 ton | cope 1 (nje) |
| • Ekskavator me zinxhir mbi 18ton | cope 1 (nje) |
| • Kamiocine | cope 1 (nje) |
| • Betoniere kantieri | cope 1 (nje) |
| • Autobot Uji | cope 1 (nje) |
| • Tabela sinjalistike | cope 10 (dhjete) |
| • Komplet i ndihmes shpejte | cope 6 (gjashte) |
| • Matrapik per thyerje betoni | cope 1 (nje) |
| • Vibrator betoni cope | cope 1(nje) |
| • Asfaltoshtruse | cope 1 (nje) |
| • Grejder | cope 1 (nje) |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- **Rul me vibrim mbi 8- ton**
- **Minieskavator**

cope 1 (nje)

cope 1 (nje)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar ne VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.*
- b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën perkatese noteriale të qerese, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.*
- c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij/tyre.*
- e) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.*
- f) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- i) Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me makinerite/pajisjet qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Lloji i mjetit	Specifikime teknike si tonazhi, kapaciteti mbajtes etj.	Pronesi/Qira	Data e nenshkrimit te kontrates qirase/blerjes se	Mandat pagesat bankare
----	----------------	---	--------------	---	------------------------

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

- **Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 18 ton** duhen per transportin e dherave ne objekt dhe materialeve te ndryshme .

- **Eskavator me zinxhir mbi 18ton** eshte I nevojshem per germim , skarifikim, hapje kasonete ne pjesen e rruges.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

- **Kamioncine** eshte e nevojshme per transportin e materialeve ndihmese dhe puntorise ne objekt.
- Betoni** kantieri eshte e domozdoshme per punime betoni ne Objekt sipas zerave te preventivit.
- **Autobot Uji** eshte i nevojshem per pserkatjen e trupit te rruges.
- Tabelat** jane te nevojshme per sinjalistiken ne objekt.
- **Komplet i ndihmes se shpejt** eshte mjaft i nevojshem per tu dhene ndihmen e shpejte punonjesve dhe manovratoreve ne objekt ne rast aksidentesh.
- Matrapik per thyerje betoni.** eshte i domozdoshem per tyerjen e elementeve beton arme.
- Vibrator betoni** eshte i domozdoshem per vibrimin dhe ngjeshjen e betonit.
- **Afaltoshtruese** eshte e domozdoshme per shtrimin e asfaltit ne rruge.
- **Grejder** eshte i nevojshme per shtrimin dhe nivelimin e materialeve te shtresave rrugore.
- **Rrul me vibrim mbi 8 ton** eshte i nevojshem per ngjeshjen e trasese se rruges dhe kapaciteti eshte i domozdoshem te jete i larte per ngjeshjen sa me te mire te rruges.
- **Minieskavatori** eshte i nevojshem per germime te ndryshme brenda objektit ku nuk futet eskavatori me zinxhire

2.3.8 Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, I Ndryshuar
Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B. Grumbullim, Transportim e mbetjeve Urbane". ose marreveshje bashkepunimi me nje subjekt te licencuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Per kriterin e vendosur te kerkeses per license QKB , III.2.B , argumentojme , qe ne baze te legjislacionit shqiptar, cdo operator ekonomik qe ushtron veprimtari ne nje territor te caktuar, duhet te hape edhe nje seli te saj , NIPT si dhe te ushtroj aktivitetin e plote si subjekt ekonomik. Mbeshtetur ne Ligjin per lejet e mjedisit si dhe VKM 419 “ Mbi procedurat e pajisjes me leje mbjedisi per ushtrimin e aktivitetit” , Subjekti qe do te kryeje punimet, klasifikohet ne operator qe gjeneron mbetje urbane ne ate njesi administrative ku do te kryeje punime. Per rrjedhoje , cdo subjekt duhet te jete i pajisur me lejen perkatese te mjedisit , ku detyrimisht percaktohen format , detyrat dhe metodat te trajtimit te mbetjeve te gjeneruara, si dhe metodat e trajtimit dhe recuperimit te nderhyrjeve. Ne kete rast bashkia eshte partneri dhe bashkepuntori qe ben te mundur trajtimin me efikas te mbetjeve, por theksojme se , nga pikepamja ligjore, eshte operatori , ai qe ben gjenerimin e mbetjeve dhe per rrjedhoje edhe ka edhe detyrimin ligjor te trajtoje keto mbetje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1: Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise(e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson

implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:

Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria e cila punon/ushtron aktivitetin në një zonë prodhimi; e cila përfshin larminë e ajrit, tokës, ujit dhe burimeve natyrore, bimëve dhe kafshëve, dhe qeniet njerëzore dhe shoqërimin e tyre me njëri-tjetrin. Iso 14001 është standardi universal i procesit të monitorimit të përpjekjeve të një organizate drejt mjedisit të saj dhe në një kuptim tjetër të hapave përpara. Është një ndërveprim sistematik që lejon të zbatohet duke i kushtuar vëmendje efekteve rreth tij gjatë periudhës nga faza e parë e prodhimit deri te dorëzimi tek perdoruesit e ketij objekti, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- c) **ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Standarti ISO 45001-2018 është standarde ndërkombëtare, të cilët parashetrojnë kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. Të dy ofrojnë udhëzime që ju ndihmojnë të hartoni dhe ngrini strukturën e kompanisë suaj mbi sigurinë dhe shëndetin në punë – duke ju dhënë mundësinë të sillni të gjithë kontrollin e duhur dhe proceset në një sistem menaxhimi. Përfitimet Standarti ISO 45001-2018 Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë janë krijimi i kushtet më të mira të punës në gjitha ndermarjet dhe shoqëritë, identifikojnë kërcënimet dhe vendosin kontrollin për menaxhimin e tyre, reduktojnë aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproductive të puntoreve, përfshijnë dhe motivojnë stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune, dëshmojnë përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve të tyre.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundeson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe në Kodin e punës, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", VKM nr. 562, datë 03.07.2013 “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës”, VKM nr. 563, datë 03.07.2013 "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës”, VKM nr.312, datë 5.5.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier si dhe në mbështetje të natyrës së objektit të prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha materialet e përshkruara në preventiv duhet të jenë sipas specifikimeve teknike. Në rast se një nga zërat e preventivit është e shkruar me emra marke automatikisht do të pranohet edhe një produkt ekuivalent.

Specifikimet teknike janë bere per permbushjen e nevojave te Autoritetit Kontraktordhe janë hartuar për çdo zë punimi sipas preventivit të punimeve, bashkelidhur dokumentave të tenderit.

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga projektuesit dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në Nr.629, DATË 15.07.2015 ”PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

Në specifikimet teknike, ne rastet kur eshte përmendur një markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, do te pranohen ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT

Specialist I fushes (Ing.topograf)
Anxhelo Dhimo

Jurist
Fjoralda Arapi

Specialiste (Ekon)
Ardisa Zhuka

MIRATOHET
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ERVIN DEMO